

E DREJTA PËR INFORMIM

28 Shtator - Dita Ndërkombëtare e së Drejtës për Informim, më shumë transparencë dhe llogaridhënie nga pushteti vendor

Zyra e Komisionerit, në bashkëpunim me projektin “Bashki të Forta” të Helvetas dhe Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), organizuan në qytetin e Lezhës aktivitetin kushtuar më 28 Shtatorit - Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Informim, një ngjarje që thekson rëndësinë e transparencës, qeverisjes së hapur dhe llogaridhënies publike.

Në hapje të tij, Komisioneri, z. Besnik Dervishi, theksoi rolin thelbësor të së drejtës për informim, si një nga të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, e sanksionuar në Kushtetutë. “E drejta për informim është një mjet kyç për të rritur besimin e publikut, për të forcuar demokracinë dhe për të garantuar kontrollin e qeverisjes nga qytetarët. Kjo ditë na kujton çdo vit se, transparenca nuk është thjesht një detyrim ligjor, por një kulturë pune e përditshme që forcon marrëdhënien mes qytetarit dhe institucioneve”, u shpreh ai.

Dervishi falënderoi organizatorët dhe partnerët: projektin “Bashki të Forta” të Helvetas, përfaqësuar nga drejtori Norbert Pijls, Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) me në krye z. Sotiraq Hroni, si dhe Bashkinë Lezhë, të përfaqësuar nga kryetari z. Pjerin Ndreu. Ai nënvizoi rëndësinë e Programeve të Transparencës, të cilat janë instrumenti bazë për ushtrimin praktik të së drejtës për informim, duke theksuar se, monitorimi i vazhdueshëm nga Zyra e Komisionerit dhe përmirësimi i tyre nga bashkitë përbëjnë një hap të rëndësishëm drejt një administrate më të hapur dhe më afër qytetarëve.



Kryetari i Bashkisë Lezhë, z. Pjerin Ndreu, theksoi se, institucioni që ai drejton si edhe ajo e Shkodrës, kanë arritur 100% nivel transparence. “Njerëzit sot i kanë sytë nga bashkia për çdo punë që bëjmë. Ne zhvillojmë konsultime publike edhe pse nuk kemi gjithmonë mundësi për t'u shfaqur në media të mëdha, por nëpërmjet rrjeteve sociale dhe faqes sonë zyrtare pasqyrojmë punën në mënyrë të rregullt. Për shkak të afërsisë dhe kontaktit të drejtpërdrejtë me qytetarët, bashkitë kanë një rol të posaçëm në forcimin e transparencës”, u shpreh Ndreu.

Nga ana e tij, z. Norbert Pijls nënvizoi se, pa informim nuk ka ndikim real. “Transparenca është themeli mbi të cilin ndërtohet pjesëmarrja

e qytetarëve. Nëse qytetarët nuk janë të informuar, nuk mund të marrin pjesë në mënyrë të përgjegjshme në vendimmarrje. Projekti “Bashki të Forta” ka synuar të përmirësojë infrastrukturën e informimit, për shembull, duke mundësuar, që mbledhjet e këshillave bashkiakë të transmetohen drejtpërdrejtë, gjë që rrit aksesin dhe besimin te qeverisja vendore. Duhet theksuar edhe autonomia e bashkive si bazë për këtë proces”, tha ai.

Në vijim, z. Sotiraq Hroni u ndal tek funksionimi i këshillave bashkiakë “të cilat duhet të funksionojnë në një nivel tjetër, ku kryetari i bashkisë të jetë në të njëjtin plan me kryetarin e këshillit. Roli i këshillit është shumë i rëndësishëm dhe përmes funksionalizimit të tij rritet transparenca, ndërsa kryetari i bashkisë ka një ndikim të madh për të përmirësuar kulturën e hapjes ndaj qytetarëve”.

Vijon në fq. 2




Ky aktivitet ishte një hap i rëndësishëm, për të nxitur dialogun mes institucioneve publike, shoqërisë civile dhe qytetarëve, me synimin për të kthyer transparencën në një praktikë të përditshme pune. Kjo tryezë shënon edhe takimin e parë të konsultimit publik të projekt-modelit të ri të Programit të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke i paraprirë takimeve të tjera në vend.

“Le të shfrytëzojmë simbolikën e kësaj dite, që festohet në mbarë botën, për të vijuar përpjekjet tona të përbashkëta, për më shumë transparencë dhe llogaridhënie, duke nxitur më shumë besim mes qytetarëve dhe institucioneve” – përfundoi fjalën e tij Komisioneri Dervishi.

Aktiviteti u mbyll me prezantimin e projekt-modelit të Programit të ri të Transparencës për njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe rubrikën e këshillave bashkiakë në këtë program, respektivisht nga Drejtorja e Përgjithshme e së Drejtës për Informim në Zyrën e Komisionerit, znj. Elona Hoxhaj dhe ekspertja e Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, znj. Marsela Dautaj. Të tilla takime parashikohet të mbahen edhe në qytete të tjera të vendit, në mënyrë që procesi i konsultimit publik të këtij dokumenti të jetë sa më i plotë.






Mblidhet Komiteti Ekzekutiv i ICIC, Dervishi: Do të vijojmë angazhimin për përmbushjen e prioriteteve të vendosura

Komiteti Ekzekutiv i Konferencës Ndërkombëtare të Komisionerëve të Informimit (ICIC) zhvilloi seancën e tretë për vitin 2025. Në cilësinë e Presidentit të Konferencës, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrotjtjen e të Dhënave Personale, z. Dervishi, falënderoi anëtarët e Komitetit për mbështetjen dhe vlerësimin e treguar ndaj Zyrës së Komisionerit, gjatë kësaj periudhe.

Duke iu referuar Konferencës së Berlinit, të mbajtur gjatë muajit qershor 2025, ai theksoi rëndësinë e vijimit të angazhimit dhe kontributit të çdo autoriteti anëtar, me synim përmbushjen e prioriteteve të vendosura të organizatës.

Në takim, u vendos që të thellohet bashkëpunimi mes ICIC dhe UNESCO-s, për promovimin e Parimeve të së Drejtës për Informim të miratuara në Konferencën e 16-të të ICIC në Berlin, me qëllim njohjen e tyre edhe nga Kombet e Bashkuara. Ky hap synon forcimin e rolit të aksesit në informacion dhe promovimin e tij në organizatat ndërkombëtare. Një tjetër vendim i rëndësishëm, ishte ngritja e Komitetit të Planifikimit për organizimin e Konferencës së ardhshme të ICIC në vitin 2026, ku pritet të përfshihen edhe përfaqësues të shoqërisë civile dhe organizmave ndërkombëtare.

Gjithashtu, Sekretariati i ICIC prezantoi disa nisma të reja, mes tyre përgatitjen e një buletini special me rastin e Ditës Ndërkombëtare të së Drejtës për Akses në Informacion 2025. Po ashtu, tre autoritete të reja, u pranuan të bëhen pjesë e ICIC, duke zgjeruar më tej përfaqësimin global të kësaj organizate.



Ligji për të dhënat e hapura, asistencë teknike nga ekspertët e BE



Zyra e Komisionerit zhvilloi trajnimin me ekspertët e projektit TAIEX mbi zbatimin efektiv të ligjit nr. 33/2022 “Për të dhënat e hapura dhe ripërdorimin e informacionit të sektorit publik”. Në këtë sesion trajnimi, stafi përfitoi njohuri të zgjeruara mbi të dhënat e hapura si:

- identifikimi dhe përgatitja e të dhënave për publikim në format të hapur;
- kriteret e publikimit të të dhënave të hapura;
- llojet e licensave;
- mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nga ana e Komisionerit;
- prezantim praktik për menaxhimin e mosmarrëveshjeve lidhur me ripërdorimin.

Gjithashtu, gjatë trajnimit, ekspertët parashtruan raste studimore dhe vendime të bazuara në praktikat e Bashkimit Evropian. Komisioneri, z. Dervishi, shprehu mirënjohjen për mbështetjen e BE dhe ekspertëve kroatë, ndërsa theksoi se “këto trajnime i shërbejnë përmirësimit të vazhdueshëm të punës së Zyrës së Komisionerit në funksion të zbatimit sa më efektiv të ligjit”.

Ekspertët kroatë u shprehën se ripërdorimi i informacionit të sektorit publik i shërben vendit dhe shoqërisë.



Me mbështetjen e projektit TAIEX të BE, Zyra e Komisionerit zhvilloi, gjithashtu, edhe një trajnim 2-ditor me përfaqësues të 38 autoritete publike në vend, për zbatimin efektiv të ligjit nr. 33/2022. Institucionet shqiptare në përmbytje të detyrimeve të këtij ligji duhet të bëjnë publike në faqet e tyre zyrtare, por dhe në portalin “opendata.gov.al” të dhënat e tyre, me qëllim ripërdorimin e këtyre dokumenteve/informacioneve nga publiku, media, organizata, biznese apo edhe kërkues shkencorë.

Qëllimi i këtij trajnimi ishte ofrimi asistencës teknike dhe këshillimore për organet e sektorit publik nga ekspertët ndërkombëtarë, duke vlerësuar kuadrin aktual ligjor dhe institucional. Gjatë trajnimit u identifikuan të dhënat publike, standardet dhe formatet e të dhënave të hapura, llojet e licensave, u dhanë udhëzime praktike mbi përgatitjen e një plani veprimi për të dhënat e hapura në institucione, si dhe u sqarua kuptimi mbi të drejtën për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik.



Drejtorja e Përgjithshme për të Drejtën e Informimit znj. Elona Hoxhaj, në fjalën e saj theksoi se, sasia e të dhënave publike në vendin tonë është rritur ndjeshëm e për pasojë ripërdorimi i këtyre të dhënave të hapura i shërben rritjes së transparencës, përgjegjshmërisë së administratës, kërkimit shkencor dhe zhvillimit ekonomik mbi zgjidhje inovatore. Znj. Hoxhaj shtoi më tej se, të dhënat e hapura përfshijnë një riorganizim dinamik të pushtetit të sektorit publik, duke hequr dorë nga roli i tij si “mbajtës i informacionit” dhe duke e ridimensionuar atë në një rol të ri, atë të “ofrimit të informacionit”.

Ekspertët e projektit TAIEX u shprehën se, Shqipëria ka një kornizë të mirë ligjore, por duhet të përmirësojë cilësinë e të dhënave dhe përditësimin e tyre. Sipas ekspertëve, të dhënat e hapura janë një e mirë publike, e cila duhet përdorur ndërsa sollën në vëmendje se duhet bërë dallimi mes të drejtës për informim dhe të dhënave të hapura dhe ripërdorimi i tyre.

Ekspertja e Zyrës së Komisionerit znj. Alketa Sata, sqaroi të pranishmit në lidhje me hapat që do të kalojë ky proces, duke theksuar se aktualisht autoriteti është në fazën e orientimit dhe ndërgjegjësimit e më pas do të kalohet në fazën e monitorimit për zbatimin e ligjit.

Vendimmarrja e Komisionerit

Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, gjatë muajit shtator 2025, ka dalë me disa vendime në zbatim të ligjit 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, i ndryshuar.

Vendim Nr . 28, datë 11.09.2025, Për urdhërimin e autoritetit publik për dhënie informacioni/ dokumentacioni - Bashkia Malësia e Madhe

Vendim Nr . 29, datë 11.09.2025, Për urdhërimin e autoritetit publik për dhënie informacioni/ dokumentacioni - Bashkia Malësia e Madhe

Vendim Nr . 30, datë 11.09.2025, Për urdhërimin e autoritetit publik për dhënie informacioni/ dokumentacioni - Bashkia Kavajë

Vendim Nr . 31, datë 11.09.2025, Për urdhërimin e autoritetit publik për dhënie informacioni/ dokumentacioni - Bashkia Kavajë

Vendim Nr . 32, datë 26.09.2025, Për rrëzimin e ankesës ndaj autoritetit publik - IdentiTek

Na ndiqni edhe në rrjetet sociale:

